## Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore

### Tab. 2: Ndryshimi mujor i indeksit të çmimeve të inputeve bujqësore tetor – dhjetor 2021 / 2020 (2015= 100)

| Kodi i IÇPB | Përshkrimi | Pesha ‰ | Pesha 1000 Euro | Tet21/ Tet20 Ndrysh. në % | Nën 21 / Nën20 Ndrysh. në % | Dhj21 / Dhj 20 Ndrysh në % |
|---|---|---|---|---|---|---|
| | **Input 1 (Mallrat dhe shërbimet aktualisht të konsumuara në bujqësi)** | | | | | |
| **200000** | **MALLRAT DHE SHËRBIMET AKTUALISHT TË KONSUMUARA NË BUJQËSI (INPUT 1)** | **556** | **126.490** | **24,5** | **25,9** | **25,6** |
| 201000 | FARËRAT DHE MATERIALI MBËLTUES | 91 | 20.777 | 6,3 | 6,4 | 7,4 |
| 202000 | ENERGJI; LUBRIFIKANT | 103 | 23.433 | 30,6 | 31,0 | 26,8 |
| 202100 | Energjia elektrike | 17 | 4.637 | 5,3 | 5,3 | 5,3 |
| 202300 | Lëndë djegëse | 137 | 17.480 | 40,3 | 40,7 | 34,8 |
| 202400 | Lubrifikant | 3 | 1.316 | 5,3 | 5,3 | 5,3 |
| 203000 | PLEHRAT DHE PËRMIRËSUESIT E TOKËS | 149 | 33.958 | 68,5 | 71,8 | 71,8 |
| 203100 | Plehrat e thjesht | 56 | 12.777 | 63,4 | 66,3 | 66,3 |
| 203200 | Plehrat e përbëra | 93 | 21.181 | 71,4 | 75,0 | 75,0 |
| 204000 | PRODUKTET PËR MBROJTJEN E BIMËVE DHE PESTICIDET | 23 | 5.137 | 1,6 | 10,0 | 16,1 |
| 205000 | SHPENZIMET VETERINARE | 38 | 8.732 | 1,4 | 2,2 | 2,2 |
| 206000 | LËNDË PËR USHQIM KAFSHËSH | 3 | 741 | 9,8 | 21,5 | 21,1 |
| 206100 | Lëndë të thjeshta ushqimi | 104 | 630 | 8,5 | 22,3 | 21,8 |
| 206200 | Lëndë të përbëra ushqimi | 12 | 111 | 17,1 | 17,2 | 17,6 |
| 207000 | MIRËMBAJTJA E MATERIALEVE | 48 | 10.883 | 1,6 | 2,7 | 2,8 |
| 208000 | MIRËMBAJTJA E NDËRTESAVE | 4 | 833 | 3,5 | 12,1 | 11,7 |
| 209000 | MALLRAT DHE SHËRBIMET TJERA | 97 | 21.996 | 1,2 | 1,1 | 1,2 |
| | **Input 2 (Mallrat dhe shërbimet që kontribuojnë në investimet bujqësore)** | | | | | |
| **210000** | **MALLRAT DHE SHËRBIMET QË KONTRIBUOJNË NË INVESTIMET BUJQËSORE (INPUT 2)** | **444** | **100.971** | **0,7** | **1,2** | **1,1** |
| 211210 | TRAKTOR | 208 | 47.375 | -0,5 | 0,0 | 0,0 |
| 211290 | TJERA | 236 | 53.596 | 2,0 | 2,4 | 2,2 |
| | **Inputi i përgjithshëm (Input 1 + Input 2)** | | | | | |
| 220000 | **INPUTI I PËRGJITHSHËM (INPUT1 + INPUT 2)** | **1.000** | **227.461** | **12,7** | **13,7** | **13,5** |

# Shpjegime metodologjike

Çmimet dhe indekset e çmimeve në këtë publikim janë kalkuluar sipas standardeve për statistikat e çmimeve të Bashkimit Evropian. Projekti për kalkulimin e këtyre çmimeve dhe indekseve të çmimeve është realizuar brenda projektit për “Përmirësimin e statistikave agromonetare” në bashkëpunim me Statistikat Suedeze dhe me mbështetjen financiare nga SIDA (Agjencia Suedeze për Zhvillim dhe Bashkëpunim Ndërkombëtar).

Çmimet janë grumbulluar në shtatë regjione: Prishtinë, Mitrovicë, Pejë, Gjakovë, Prizren, Ferizaj dhe Gjilan. Çmimet janë grumbulluar çdo muaj rreth datës 15. Që nga fillimi numri i artikujve për të cilët janë grumbulluar çmimet është rritur hap pas hapi.

Qëllimi i Indeksit të çmimit të inputeve bujqësore është përcjellja e çmimeve të blerjes të mjeteve për prodhim bujqësor. Sipas definicionit, indeksi nuk i mbulon faktorët e prodhimit. Rrjedhimisht, rrogat dhe kostoja e rrogave, qiraja, pagesa e kamatës, blerja e tokës dhe kafshët si asete fikse nuk janë pjesë e fushë-vëzhgimit.

Për të krahasuar indeksin e BE-së të paraqitur në këtë publikim me shtetet tjera, rekomandohet faqja elektronike e Eurostat-it (http://epp.eurostat.ec.europa.eu/portal/page/portal/eurostat/home).

Peshat për kalkulimin e indekseve të agreguara kryesisht janë bazuar në Llogaritjet ekonomike bujqësore 2015, që është viti bazë në indeks (2015=100). Këto pesha janë fikse përderisa baza e indeksit është viti 2015. Indeksi është indeks i çmimit dhe kalkulohet bazuar në formulën e *Laspeyres*.

**Llogaritja e indeksit elementar të çmimeve**

Llogaritja e indeksit elementar të çmimit

Llogaritja e indekseve elementare është bërë në përgjithësi duke përdorur formulat në vijim, me çmim mesatar aritmetik të papeshuar.

$$R_i^t = \frac{\frac{1}{n}\sum P_{ij}^t}{\frac{1}{n}\sum P_{ij}^o} \cdot 100$$

| | | |
|---|---|---|
| Rti | - | Indeksi elementar për muajin t dhe prodhimin i |
| P | - | Çmimi i grumbulluar |
| I | - | Prodhimi i |
| J | - | Çmimi j i regjistruar për prodhimin (në përgjithësi çmimi për regjionin) |
| T | - | Muaji i vëzhguar |
| 0 | - | Muaji bazë |

Llogaritja e indeksit të agreguar të çmimit

Llogaritja e indeksit të agreguar për totalin e inputeve ose nëngrupeve të indeksit të inputeve është bërë duke shfrytëzuar formulën në vijim.

$$I^t = \sum (R_i^t \cdot \frac{w_i^0}{\sum w_i^0})$$

| | | |
|---|---|---|
| It | - | Indeksi i agreguar për periudhën t |
| W0i | - | Faktori peshues në periudhën bazë për prodhimin i |
| i | - | Prodhimi i |
| t | - | Muaji i vëzhguar |
| 0 | - | Muaji bazë |

**Pyetësori**

| DEFINICIONI -Përcaktimi i cakut (artikujve- vareteteve) |
|---|
| |

| Numri i artikullit | Emri i artikullit | | | Sasia | Njësia | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Grumbulluesi i çmimit | | | | Vendi i grumbullimit / Ndërmarrja | | |
| Data | | | | | | |
| Çmimi | | | | | | |

Shënimet e anketuesve

- Përshkrimi hollësishëm i artikullit (varietetit) specifik të zgjedhur për monitorim te çmimit
- Ndryshimet në përshkrimin e hollësishëm, data e ndryshimeve
- Trajtimi i ndryshimit të kualitetit kur përshkrimi është ndryshuar ( informacionet e vrojtimeve të dyfishta te çmimit, plotësuese dhe vlerësimi i ndryshimit të kualitetit)

- **Adresa: AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS,**
  Rr. ”Zenel Salihu”, nr. 4, 10000 Prishtinë
- **Telefoni:** +383 (0) 38 200 31 129
  Kryeshefi Ekzekutiv: +383 (0) 38 200 31 112
- **Fax:** +383 (0) 38 235 033
- **E-mail:** **infoask@rks-gov.net**
- **Ueb-faqe:** **http://ask.rks-gov.net**


- © : Agjencia e Statistikave të Kosovës,
- Riprodhimi autorizohet nëse tregohet burimi.